



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 22.3.1-2013-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË GJAKOVËS**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013**

**Prishtinë, Qershor 2014**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, ndërsa mund të ndër marr edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t'i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Gjakovës në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit Florim Beqiri i mbështetur nga Lavdim Maxhuni (Udhëheqës Ekipi) Mexhit Ferati dhe Shpresa Zenelaj.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia .....	7
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak .....	12
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli .....	13
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	36
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak .....	39

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-të) për vitin 2013 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Kryetarin e Komunës dhe ekipin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2013 u ndërmor në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorit Publik. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 02.10.2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse për Pasqyrat Vjetore Financiare të theksuara në Memon e Planifikimit të Auditimit;
- Reagimin ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Komunës së Gjakovës (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit)

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

### Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes* Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është plotë dhe i saktë për arsye se ekzistojnë prona, lokale dhe shtëpi të komunës që nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël dhe nuk janë prezantuar në PVF. Po ashtu komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve kishte paguar për mallra dhe shërbime vlerën prej 52,300€, dhe për shpenzime komunale vlerën prej 54,300€. Regjistri

i pasurive fikse dhe keq klasifikimi ekonomik i shpenzimeve nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Vjetore Financiare ('Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme' dhe 'Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale'), në pajtim me SNKSP në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme. (SNISA 200 Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).

### Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Menaxhmenti i Komunës kishte dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm, por këto kontrole nuk kishin funksionuar në disa fusha të rëndësishme të menaxhimit financiar. Këto duhet në vazhdimësi të monitorohen për t'u siguruar se janë duke funksionuar siç duhet. Ne në vazhdim po i paraqesim fushat në të cilat janë vërejtur mangësi:

- Pasqyrat Vjetore Financiare, përveç shpalosjes së plotë të pasurive dhe keq klasifikimeve ku nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve ishin bërë pagesa për mallra dhe shërbime dhe komunal, ishin përgatitur në pajtim me rregullën e thesarit nr. 03/2013;
- Rekomandimet e vitit 2012 dhe të viteve të mëparshme nuk janë adresuar ende si duhet. Kjo ka rezultuar në kontrole të dobëta/vlerë të dobët për para/humbje potenciale financiare të vazhdueshme. Këtë e vërteton edhe neglizhenca për të hartuar planin e adresimit të rekomandimeve,;
- Menaxhmenti nuk është marrë seriozisht me adresimin e rekomandimeve të dhëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, dhe nuk është plotësuar me stafin shtesë. Nuk ka të formuar komitet të auditimit që është kërkesë ligjore; dhe
- Edhe pse ne arritëm të merrnim siguri nga kontrollet efektive të menaxhmentit në disa fusha të pasqyrave, vlerësimi ynë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ka nxjerr në pah se në disa fusha të rëndësishme të veprimtarisë ekzistojnë dobësi domethënëse. Kjo veçanërisht ka ndodhur në prokurim, ku kontratat janë menaxhuar dobët. Komuna kishte lidhur kontrata për projekte pa pasur mjete të mjaftueshme dhe si rezultat i saj ka hyrë në obligime financiare më shumë se sa ndarjet buxhetore, pastaj të hyrat nuk janë menaxhuar si duhet, sidomos dhënia me qira e lokalëve dhe tokave nga. Po ashtu, tek kategoria e subvencioneve shfrytëzimi i mjeteve nga kjo kategori ishin bërë për mallra dhe shërbime dhe nuk kishte pasur raportim për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve.

**Rekomandimet kryesore të Auditorit të Përgjithshëm për Kryetaren e Komunës janë si në vijim:**

- Të sigurojë që në procesin e hartimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 të përfshihet formalisht edhe rishikimi nga menaxhmenti i draft pasqyrave, me fokus të veçantë në fushën e regjistrimit të plotë të pasurive në regjistrin kontabël dhe tek klasifikimi i drejtë i shpenzimeve sipas kategorive ekonomike;
- Të sigurojë se do hartohet një plan i veprimit ku do të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme;
- Të bëjë një analizë për lokalet dhe pronat e dhëna me qira, duke i rishikuar të gjitha kontratat ekzistuese të qiramarrësve, dhe të siguroj mekanizmat efektiv për rritjen e inkasimeve;
- Të kryejë një vlerësim të detajuar të proceseve të prokurimit dhe kontrolleve të brendshme për të kuptuar se pse dobësitë vazhdojnë të përsëriten dhe të identifikojë veprimet që duhen të ndërmerren për t'i adresuar këto dobësi.
- Të shtojë kontrollet tek menaxhimi i kontratave të prokurimit në mënyrë që mos hyjë në obligime pa sigurimin e fondeve;
- Të shqyrtoj me një kujdes të shtuar adresimin e të gjitha rekomandimeve të auditimit të brendshëm për të përmirësuar sistemin e kontrollit të brendshëm, dhe njëherit të plotësoj këtë njësi me stafin shtesë;
- Të siguroj se mjetet nga kategoria e subvencioneve të mos shpenzohen në kategori tjera ekonomike dhe shpenzimi i mjeteve nga kjo kategori të bëhet në mënyrë sa më transparente duke raportuar për mënyrën se si po shfrytëzohen subvencionet; dhe
- Të formojë një komision kompetent për të regjistruar të gjitha pasuritë që janë në pronësi të komunës (pronat, lokalet dhe pasuritë tjera), si dhe të azhurnohen regjistrat e pasurive në vazhdimësi.

**Përgjigja nga Menaxhmenti - auditimi për 2013**

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha gjetjet e auditimit dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet tona.

# 1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Menaxhmentit të përgatis PVF sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar shkallën deri në të cilën mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale gjatë përcaktimit të testimit të hollësishëm, të cilat janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm dhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët, do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

## 2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklaratë kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

### 2.1 Opinioni i Auditimit

#### *Opinion i Pamodifikuar<sup>1</sup> me Theksim të Çështjes*

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes* Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është plotë dhe i saktë për arsye se ekzistojnë prona, lokale dhe shtëpi të komunës që nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël dhe nuk janë prezantuar në PVF. Po ashtu komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve kishte paguar për mallra dhe shërbime vlerën prej 52,300€, dhe për shpenzime komunale vlerën prej 54,300€. Regjistri i pasurive fikse dhe keq klasifikimi ekonomik i shpenzimeve nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Vjetore Financiare ('Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme' dhe 'Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale'), në pajtim me SNKSP në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme. **(SNISA 200 Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).**

<sup>1</sup> Termi „opinion i pamodifikuar“ është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar“ i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (SNISA 200). Për më tutje referohu në shtojcën I.



## 2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

### Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 02.10.2013, janë identifikuar dy rreziqe domethënëse: atë për regjistrimin e të gjitha pasurive që kanë ndikim në PVF-të dhe shpalosjen e pagesave nga palët e treta.

Këto janë rreziqe të anomalive materiale, nga të cilat mund të rezultojë një opinion i modifikuar, përfshirë Theksimin e Çështjes.

Rreziku i anomalive materiale që ne kemi identifikuar në lidhje me regjistrimin dhe prezantimin e pasurive, në PVF-të ka ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë veprime për të adresuar këtë rrezik.

### Rreziku i identifikuar

#### Çështja 1- Prezantimi i pagesave nga palët e treta në PVF-të

##### E gjetura

Rreziku për pagesat nga palët e treta nuk ka ndodhur sepse komuna i kishte prezantuar ato drejt dhe saktë në PVF.

### Rreziku i identifikuar

#### Çështja 2 - Mungesa e regjistrimit të pasurive që janë në pronësi të komunës

Pasuritë në pronësi të Komunës si lokalet, banesat dhe pronat nuk janë identifikuar dhe regjistruar në regjistrat e pasurive, duke rezultuar kështu në anomali materiale në shënimet e pasurive në PVF.

##### E gjetura

Ne i kemi vlerësuar kontrollat e zbatuara nga menaxhmenti për ta dëshmuar se a janë regjistruar të gjitha pasuritë që janë në pronësi të komunës në regjistrat e pasurive. Në memon e auditimit të ndërmjetëm, ne i kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimin që nevojitet për të siguruar që shifra e pasurive në PVF të jetë e saktë. Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar, sepse Menaxhmenti nuk ka arritur të aplikojë përmirësimet e nevojshme në kontrollin e brendshëm dhe ne kemi konfirmuar që vlerat e pasurive të regjistruara në PVF janë materialisht të pasakta.

**Rekomandimi 1 – Prioritet i lartë** – Kryetarja e Komunës duhet të identifikojë veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurive në vitin 2014

## 2.3 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

### Përshkrimi

PVF duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare (RrF) nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- PVF janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në MF;
- PVF janë nënshkruar nga ZKA (Kryetari i Komunës) dhe ZKF;
- PVF janë pranuar në gjuhën shqipe dhe serbe;
- PVF janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike; dhe
- Komuna ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore në Kuvendin Komunal dhe një kopje tek Ministri i Ministrisë së Financave gjatë vitit 2013.

PVF fillestare kanë përmbajtur disa gabime. Ne gjatë procesit të auditimit u kemi dhënë mundësitë për korrigjim. Më pastaj, ato ishin korrigjuar. Përveç shpalesjes së plotë të pasurive dhe keq klasifikimit të disa shpenzimeve, PVF-të finale ishin përgatitur në pajtim me rregullën e Thesarit nr. 03/2013.

---

### Çështja 2 - Procesi i përgatitjes së Pasqyrave - Prioriteti i lartë

**E gjetura** Të shënimi 30 Përmbledhje e pasurive jo financiare kapitale pasuria e paraqitur me vlerë mbi 1,000€, në PVF është 38,469,845€. Kjo pasuri nuk është e plotë dhe e saktë për arsye se ekzistojnë prona, lokale dhe shtëpi që janë verifikuar nga komisioni komunal e të cilat nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël dhe nuk janë prezantuar në PVF.

Po ashtu, të shënimi 31 Përmbledhje e pasurive jo financiare me vlerë nën 1,000€, vlera që e ka prezantuar komuna në PVF prej 228,000€ nuk është e saktë sepse nuk është përfshirë pasuria e drejtorisë së arsimit dhe drejtorisë së shëndetësisë.

Komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve kishte paguar për mallra dhe shërbime vlerën prej 52,300€, dhe për shpenzime komunale vlerën prej 54,300€.

- Rreziku** Mos prezantimi i plotë i pasurive që i posedon komuna rritë rrezikun se do keqkuptohet pozita financiare dhe keqpohimin e pasurive në PVF. Po ashtu, keq klasifikimi i shpenzimeve ndikon që të nënvlerësohen shpenzimet e subvencioneve dhe të mbivlerësohen mallrat dhe shërbimet.
- Rekomandimi 2** Kryetarja e Komunës duhet të siguroj se plani sistematik i përpilimit të pasqyrave financiare inkorporon kërkesën për të përfshirë tërë vlerën e pasurive. Menaxhmenti ka nevojë të monitoroj zbatimin e kësaj kërkesë. Klasifikimi i gabuar i kodeve ekonomike, gjithashtu, pasqyron shpenzimet në mënyrë të pa saktë dhe regjistrimet si të tilla duhet të jenë në pajtim me Planin kontabël të Thesarit.

## 2.4 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

### Përshkrim

Përveç hartimit të PVF-ve, nga Komuna kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesa Buxhetore për financimin e projekteve kapitale në MF;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Raporti i vetëvlerësimit sipas rregullave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK);
- Draft Plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë;
- Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve; dhe
- Raportet mbi borxhet e dorëzuara në MF.

## 3 Rekomandimet e vitit paraprak

### Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti i komunës nuk i kishte kushtuar vëmendjen e duhur rekomandimeve të dhëna në vitin e kaluar dhe kjo ka shkaktuar që të njëjtat rekomandimet të përsëriten edhe këtë vit.

### Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2012 kishte rezultuar në 18 rekomandime. Menaxhmenti i komunës nuk ka përgatitur një Plan Veprimi se si mendon të adresohen rekomandimet e dhëna.

Në fund të auditimit ne kemi vërejtur se dy rekomandime ishin adresuar plotësisht; katër ishin adresuar pjesërisht apo janë në proces të adresimit, dhe 12 nuk ishin adresuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II në fund të këtij raporti.

---

### Çështja 3 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

**E gjetura** Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2012 ka rezultuar me 18 rekomandime kryesore. Menaxhmenti i komunës nuk ka përgatitur një Plan Veprimi për të siguruar se të gjitha rekomandimet adresohen brenda periudhës së specifikuar, dhe kjo ka rezultuar që një numër i vogël i rekomandimeve të adresohen.

**Rreziku** Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të brendshme në sistemet financiare kyçe, si Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë rezultuar në:

- Menaxhim jo të mirë të subvencioneve;
- Mungesa e kontrolleve të mjaftueshme tek të hyrat, ka rezultuar me një shkallë të ultë të inkasimit;
- Jo efikasiteti i vazhdueshëm organizativ dhe vlera e dobët për para në praktikën e prokurimit; dhe
- Hyrja në obligime pa i zotuar mjetet e nevojshme, ka shkaktuar që në fund të vitit të rriten obligimet.

**Rekomandimi 3** Kryetarja e Komunës duhet të sigurojë se fillimisht do të përgatisë një planë të veprimit ku do të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar në fushat më të rëndësishme.

## 4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

### 4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar MFK efektiv dhe rezultateve nga këto veprime. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ky nivel, për shembull, mund të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrollet operative të nivelit më ulët. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, mirëpo nuk po zbatohen në praktikë dhe nuk po funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, duke përfshirë rolin e ndërmarrë nga Auditimi i Brendshëm dhe Komitetet e Auditimit.

Ne gjithashtu kemi marrë në konsideratë vetë-vlerësimin e Komunës të ndërmarrë në kuadër të Menaxhimit të Financave Publike në lidhje me vetë-vlerësimin e KBFP.

Ne kemi gjetur se kontrollet mbi të hyrat nuk po zbatohen në mënyrë efektive, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojë që komuna të ketë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv të projektit. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë: Prokurimi, Të hyrat, Subvencionet, Menaxhimi i pasurisë, Obligimet e papaguara.

## 4.2 Qeverisja e mirë

### Përshkrim

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur për të mundësuar përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

---

### Çështja 4 - Dobësi në kontrollet e menaxhmentit të lartë

**E gjetura** Rishikimi që ne i kemi bërë kontrollove menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar kryesor të komunës ka nxjerrë në pah një raportim të dobët mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë. Kjo ka ndodhur për shkak se nuk ka pasur raportime të rregullta me shkrim prej drejtorive përkatëse tek kryetari i komunës mbi punët dhe aktivitet e drejtorateve. Ne nuk jemi mbështetur në funksionimin e kontrolleve të nivelit të lartë tek shumica e kategorive ekonomike.

**Rreziku** Cilësia e dobët e raportimit financiar tek menaxhmenti i lartë redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar në mënyrë aktive aktivitetet e komunës dhe dëmton kontrollin efektiv buxhetor. Kjo mund të rezultojë në deficit ose suficit të paplanifikuar dhe të vonojë veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato. Kjo mund të ndikoj në ruajtjen e ekuilibrit buxhetor.

**Rekomandimi 4** Kryetarja e Komunës duhet të rishikojë formën e raportimit tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të paraqesë një zgjidhje të përshtatshme deri në fund të vitit.

## 4.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

### Përshkrimi

Në kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për Komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – shpenzimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>19,022,218</b>	<b>19,931,360</b>	<b>18,783,539</b>	<b>19,624,022</b>	<b>18,049,205</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	16,122,218	16,422,218	16,254,860	16,448,318	15,649,501
Të bartura nga viti paraprak <sup>3</sup>	-	335,360	333,255	491,511	415,588
Të hyrat vetanake <sup>4</sup>	2,900,000	2,900,000	2,074,262	2,449,266	1,894,746
Donacionet e brendshme	-	242,372	110,646	199,222	43,288
Donacionet e jashtme	-	31,410	10,516	35,705	46,082

Buxheti final, krahasuar me buxhetin fillestar, është më i lartë për 909,142€. Kjo rritje është rezultat i vendimeve të qeverisë për fondet shtesë për projektet kapitale, donacioneve vendore dhe të jashtme dhe të hyrave të bartura nga viti paraprak.

Në vitin 2013 Komuna ka shpenzuar 94% të buxhet final, përderisa në vitin 2012 buxheti ishte shpenzuar 97%. Marrë në tërësi, kjo është një shkallë mjaft e lartë e ekzekutimit, ndërsa për aspektin e rregullsisë, do të flitet në vijim të këtij raporti.

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

<sup>3</sup> Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>4</sup> Të hyrat komunale të planifikuara dhe të mbledhura në vitin aktual që është përdorur nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- shpenzimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>19,022,218</b>	<b>19,931,360</b>	<b>18,783,539</b>	<b>19,624,022</b>	<b>18,049,205</b>
Pagat dhe Mëditjet	10,216,359	10,206,650	10,149,794	10,196,103	9,785,772
Mallrat dhe Shërbimet	1,557,855	1,639,653	1,522,469	1,708,009	1,373,884
Shërbimet komunale	693,600	690,100	650,300	649,066	530,617
Subvencionet dhe Transferet	548,000	602,300	457,649	1,069,566	446,837
Investimet Kapitale	6,006,404	6,792,657	6,003,327	6,001,278	5,912,095

**Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:**

- Rritja e buxhetit të Investimet Kapitale ishte bërë një pjesë me vendim të qeverisë prej 269,000€, nga të hyrat e bartura 265,000€ si dhe nga participimet e donatorëve vendor dhe të jashtëm në vlerë 252,000€. Buxheti të kjo kategori është shpenzuar 88%. Arsyeja për këtë ishte se komuna ka planifikuar që prej të hyrave vetanake të investoj në kategorinë e kapitaleve mirëpo nuk e ka realizuar planin e paraparë për të hyrat;
- Rritja e buxhetit për kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve kishte ndodhur nga të hyrat e bartura të vitit të kaluar me vlerë 66,000€ dhe një pjesë nga donatorët prej 13,000€. Po ashtu, edhe te kjo kategori komuna nuk ka realizuar të hyrat e planifikuara;
- Buxheti fillestar ne raport me buxhetin final për Paga dhe Mëditje dhe Shërbimet komunale nuk kishte ndonjë ndryshim që vlen të ceket;
- Një planifikim jo i mirë ishte për subvencione dhe transfere, dhe komuna nga kjo kategori kishte shpenzuar vetëm 76%;
- Komuna ka pranuar gjithashtu grande nga donatorët vendor në vlerën 242,372€. 110,646€ janë shpenzuar në kuadër të kategorisë së Investimeve Kapitale për projektet e ndërtimit të rrugëve, dhe mbi 130,000€ kanë mbetur të pa shpenzuara; dhe
- Asnjë vit të hyrat vetanake nuk shpenzohen në tërësi, si rezultat direkt i mos ekzekutimit të buxhetit, duke pasur parasysh se të hyrat vetanake janë burimi i fundit financiar i përdorur. Në vitin 2014 vlera e bartur e të hyrave ka qenë mbi 298,000€.



**Tabela 3. Të hyrat vetjake komunale të buxhetuara dhe të mbledhura në 2013 (në euro)**

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	2013 Pranimi	2012 Pranimi	2011 Pranimi
Të hyrat vetanake	2,900,000	2,900,000	2,370,064	2,778,027	2,382,421

Buxheti fillestar për të hyrat vetanake nuk pasqyronte pranimet e vitit të kaluar dhe faktorët e tjerë relevant. Nga tabela shihet se realizimi i të hyrave ishte 82%. Në krahasim me vitin paraprak, të hyrat e planifikuara ishin për 17% më të ulëta.

Në anën tjetër, listat e debitorëve ndaj komunës kanë kaluar shifrën prej 5.7 milionë, që paraqet një shumë domethënëse. Gjendja e llogarive të arkëtueshme është në rritje të vazhdueshme.

#### **Çështja 5 - Ekzekutimi i buxhetit - Prioriteti i Lartë**

**E gjetura** Ekzekutimi i buxhetit në nivel të përgjithshëm ishte në nivelin e pritur, përveç te kategoria e investimeve kapitale dhe te subvencionet. Pjesa e buxhetit të pa shpenzuar prej 12% për projektet kapitale ishte për arsye të mos inkasimit të hyrave vetjake dhe mbylljes së afatit të zotimeve si rezultat i vonesave në alokimin e të hyrat vetanake. Te kategoria e subvencioneve, arsyeja e shpenzimit vetëm 76% ishte si rezultat i mos inkasimit të hyrave që kanë qenë të parapara me buxhet.

**Rreziku** Ekziston një mospërputhje e lartë në mes planit dhe shpenzimeve. Planifikimi i dobët i shpenzimeve ka ndikuar në ngecjen dhe mosrealizimin e projekteve kapitale. Gjithashtu, shpenzimet e planifikuara për subvencione dhe transfere nuk kanë arritur qëllimin, ngase gati ¼ prej tyre, nuk janë përdorur.

**Rekomandimi 5** Kryetarja e Komunës duhet të vendos një qasje me qëllim të përmirësimit të planifikimit buxhetor. Para se të vendosen zërat buxhetor, komuna duhet të analizoj me kujdes dhe me objektivitet se cilat projekte janë prioritare dhe cilat prej tyre kanë gjasa reale të realizohen. Përveç kësaj, Kryetarja e komunës duhet të monitorojë në mënyrë sistematike performancën buxhetore në baza mujore, sidomos të kategoria e investimeve kapitale, si dhe subvencionet dhe transferet në mënyrë që të identifikojë dhe adresojë me kohë barrierat potenciale.

### **Çështja 6 - Mos planifikim i mirë i buxhetit-Piritet i lartë**

- E gjetura** Ne kemi vlerësuar se komuna nuk kishte bërë një planifikim të mirë të buxhetit në vitin 2013. Disa projekte kapitale kishin filluar për tu realizuar pa qenë të përfshira në buxhetin e vitit aktual. Gjithashtu, tek Mallrat dhe Shërbimet, komuna kishte planifikuar buxhet për derivate në vlerë prej 134,200€, ndërsa kishte shpenzuar 158,118€.
- Rreziku** Nënshkrimi i kontratave të prokurimit jashtë planifikimeve buxhetore rritë rrezikun që këto projekte të mos përfundohen për mungesë fondesh. Përveç kësaj, komuna potencialisht mund të bëhet subjekt i kontesteve gjyqësore.
- Rekomandimi 6** Kryetarja e Komunës duhet të siguroj se gjatë procesit të planifikimit të përfshihen të gjithë akterët e nevojshëm dhe të gjitha informacionet relevante në mënyrë që bëhet një planifikim i qëndrueshëm buxhetor.

## 4.4 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

### Përshkrimi

Të hyrat e gjeneruara nga Komuna në vitin 2013 ishin në total 2,370,064€. Zërat kryesor që përbëjnë shumat e mbledhura janë: Të hyrat nga tatimi në pronë; Të hyrat nga lejet e ndërtimit; Taksat administrative etj.

---

### Çështja 7 - Tatimi në pronë - Prioritet i lartë

**E gjetura** Duke u mbështetur në të dhënat e ofruara nga softueri i tatimit në pronë komuna për vitin 2013 kishte faturuar 26,438 obligues me vlerë prej 1,633,149€. Ka arritur të inkasoj shumën 1,066,945€ apo 65% të shumës së planifikuar. Ne kemi marrë për testim 19 mostra (kartela financiare) me vlerë 40,602€. Prej tyre, vlera e papaguar ishte 31,152€. Sipas zyrtarit përgjegjës komuna gjatë vitit 2013 kishte pasur vështirësi për të kryer anketimet në teren për futjen e pronave të reja në data bazën e tatimit në pronë në mënyrë që pastaj kjo të ndikoj në rritjen e inkasimit të të hyrave. Arsyet për këto vështirësi sipas zyrtarit përgjegjës ishin se pajisjet (GPRS) nuk kishin funksionuar. Po ashtu, mungesa e automjeteve zyrtare kishte qenë pengesa tjetër për t'i kryer punët. Borxhi i grumbulluar për vite në total ndaj komunës për tatimin në pronë ishte 4,019,000€. Komuna nuk kishte hartuar ndonjë strategji me mekanizmat e duhur se si të mblidhen këto borxhe.

**Rreziku** Mos realizimi i të hyrave nga tatimi në pronë për vitet e kaluara ndikon që të hyrat e komunës të zvogëlohen dhe redukton mundësinë e realizimit të shumë projekteve potenciale me vetëfinancim. Po ashtu, mos funksionimi i pajisjeve (GPRS) dhe mungesa e automjeteve zyrtare për kryerjen e procesit të anketimit, ndikon që të hyrat nga tatimi në pronë të mos realizohen.

**Rekomandimi 7** Kryetarja e Komunës duhet të rishikoj politikat aktuale dhe të propozoj masat dhe veprimet konkrete për mbledhjen e këtyre borxheve, duke mos përjashtuar edhe masat administrative dhe gjyqësore. Po ashtu, Kryetarja e Komunës duhet të siguroj se çështja e anketimit të pronave do të mundësohet si pjesë e aktiviteteve të rregullta, në mënyrë që të bëhet futja e të gjitha pronave të reja në data bazën e tatimit në pronë.

### Çështja 8 - Lejet e ndërtimit - Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna nga lejet e ndërtimit gjatë vitit 2013 kishte planifikuar që të realizoj shumën prej 420,000€, ndërsa kishte inkasuar vlerën prej 212,342€ (51%).

Ne kemi testuar 5 mostra dhe kemi identifikuar se në këto raste mungon skica nga projekti kryesor. Kjo tregon se si është bërë kalkulimi në vlerë financiare i sipërfaqes së objektit për të cilin është dhënë leja e ndërtimit. Po ashtu, në një rast kemi identifikuar se një person fizik ishte ngarkuar me 1,597€, më tepër se që përcaktohet me rregullore mbi tarifa dhe ngarkesa.

**Rreziku** Mungesa e një metodologjie të qartë të kalkulimit të tarifave për lejet e ndërtimit rritë rrezikun që shumat e kalkuluar të mos jenë në pajtim me rregulloret mbi tarifatat dhe ngarkesat, dhe kështu, të dëmtohet ose buxheti i komunës ose investitorët e ndërtimit.

**Rekomandimi 8** Kryetarja e Komunës duhet të siguroj se kontrole shtesë mbi kalkulimin e tarifave të ndërtimit janë vendosur, dhe baza mbi të cilat janë bërë kalkulimet, është e qartë dhe e dokumentuar.

### Çështja 9 - Të hyrat nga pronat e dhëna me qira - Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna nga të hyrat për lokalet e dhëna me qira dhe tokat kishte planifikuar të realizoj 60,000€, ndërsa kishte inkasuar 19,000€. Lista e ofruar nga zyrtari përgjegjës për lokalet e dhëna me qira nuk është e plotë dhe nuk dihet numri i saktë i kontratave të qiradhënies së pronave publike të komunës. Ne kemi testuar 13 mostra ku i kemi identifikuar këto mangësi:

Në gjashtë raste të dhënies me qira të lokaleve, kontratat kanë skaduar në vitet 2000 dhe 2001. Aktualisht, lokalet shfrytëzohen nga qiramarrësit pa pasur kontratë. Komuna vazhdon t'i ngarkojë këta persona fizik pa pasur bazë ligjore.

Në shtatë raste tek dhënia e pronës me qira, kontratat ishin nënshkruar në vitin 2009, mirëpo gjashtë prej tyre nuk kishin paguar asnjëherë qira ndaj komunës. Menaxhmenti i komunës nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim për të inkasuar borxhet e mbetura, të cilat kishin arritur shumën prej 66,374€.

**Rreziku** Menaxhimi i dobët i kontratave të qiradhënies rrit rrezikun e mos inkasimit dhe humbjes së të hyrave. Mungesa e evidencave të plota për ngarkesa dhe pagesa për të gjithë qiramarrësit e objekteve, gjithashtu mund të ketë si pasojë nën pagimin e qirasë.

**Rekomandimi 9** Kryetarja e Komunë duhet të zbatoj një proces rishikimi të kontratave të qiradhënies së pronave, si dhe gjendjen e objekteve/pronave që shfrytëzohen pa kontrata formale me komunën. Regjistrimi të të gjitha pronave dhe ngarkesave shoqëruese, duhet të shqyrtohet të paktën çdo gjashtë muaj.

#### **Çështja 10 - Taksat për veprimtari biznesore - Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Komuna ka inkasuar gjithsej 121,023€, nga taksa për veprimtari biznesore për vitin 2013, krahas 169,792€ në vitin 2012. Në Komunë operojnë afro 4,830 biznese, të cilat ngarkohen me një shumë totale prej 280,667€ për vitin 2013. Ne kemi testuar 15 mostra që kapin vlerën prej 12,486€. Prej tyre, ishin inkasuar rreth 51% dhe kishin mbetur borxhe të pa mbledhura 6,090€. Borxhet e grumbulluara nga vitet e kaluara arrijnë shumën prej 1,069,000€

Sipas pohimeve të zyrtarëve, inkasimi jo i mirë nga licencat e biznesit është si rezultat i ngarkesave të një numri të madh të bizneseve të cilat nuk janë aktive. Softueri i shfrytëzuar nga komuna për këtë veprimtari nuk ofron raporte të sakta mbi gjendjen e bizneseve që operojnë brenda vitit.

**Rreziku** Inkasimi duket të jetë i dobët. Vonesat në mbledhjen e të hyrave sjellin dështimet në vendimmarrjen e menaxhmentit për financimin e projekteve të parashikuara nga burimet vetjake.

**Rekomandimi 10** Kryetarja e Komunës duhet të siguroj se departamenti i të hyrave do të krijoj një bazë të plotë të dhënash, e cila do të gjeneroj raporte të sakta mbi gjendjen reale të ngarkesave ndaj debitorëve, si dhe të merr masa adekuate për reduktimin e këtyre borxheve, duke mos përjashtuar edhe masat ligjore.

## 4.5 Shpenzimet

### 4.5.1 Prokurimi

#### **Përshkrimi**

Komuna ndonëse ka të dizajnuara kontrolle formale mbi shpenzimet, ato nuk operojnë në mënyrën e duhur. Nënshkrimi i kontratave pa zotime të mjaftueshme, shpërblimi i ofertuesve të papërgjegjshëm, mungesa e evidencave për servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve, po ashtu edhe kontrollet e dobëta tek shpenzimet e derivateve, janë vetëm disa raste që përshkruajnë dështimin e kontrolleve.

Kontratat që kanë kaluar nëpërmjet procedurave të prokurimit për vitin 2013 kapin një vlerë prej 7,138,454€.

Ne kemi analizuar nëse projektet për investime kapitale kanë qenë të përfshira në PIP dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Gjithashtu, kemi rishikuar edhe ndryshimin e projekteve të parapara gjatë vitit. Vlerësimet tona janë se sistemi i Programit për Investime Publike (PIP) si një sistem për menaxhimin e investimeve kapitale, nuk ishte përdorë në mënyrën e duhur. Disa kontrata për vitin 2013 nuk ishin të parapara me PIP. Raste të tilla janë me kontratën "Ndërtimi i parkut memorial në fshatin Meje" në vlerë 1,060,774€ dhe "Ndërtimi i rrugës në fshatin Skivjan" në vlerë 800,000€. Për këto kontrata, në sistemin e PIP-it nuk ishte planifikuar buxhet për vitet e ardhshme (2014 dhe 2015).

Te Kontrata me numër të prokurimit 014 "Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në Çarshinë e madhe në Gjakovë me vlerë 219,945€, ne nuk e kemi testuar këtë lëndë për arsye se ishte marrur për hetime nga departamenti i krimeve të rënda në Gjakovë.

Ne kemi ekzaminuar një mostër prej 84 pagesash, që kapin vlerën prej 1,012,367€, dhe 16 kontrata që kanë shkuar përmes procesit të prokurimit që kapin vlerën prej 4,193,100€, dhe kemi identifikuar:

### **Çështja 11 - Mosrespektimi i kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit dhe ndërhyrja tek pozicioni i çmimeve – Prioritet i lartë**

**E gjetura** Tek projekti “Rrethimi i oborrit dhe ndërtimi i terrenit sportiv në gjimnaz” me vlerë 77,222€, komisioni vlerësues kishte ndërhyrë në specifikacionin e ofruar nga kompania fituese te pozicioni numër 9 te kolona e çmimit. Operatori ekonomik kishte ofruar çmimin prej 1€, ndërsa komisioni vlerësues e ka korrigjuar në 1,134€. Sipas Ligjit për prokurim publik (LPP), korrigjimi i çmimeve nga komisioni vlerësues nuk është i lejuar.

Te kontrata “Furnizim me pjesë rezervë dhe riparimi i automjeteve zyrtare” me vlerë prej 132,678€, njëri nga kriteret e vendosura në dosjen e tenderit ishte që operatori ekonomik të ketë së paku dy referenca të natyrës së njëjtë. Ne kemi konstatuar se në dosjen e kompanisë fituese mungojnë këto referenca.

**Rreziku** Dështimi i ndjekjes së procedurave të duhura të prokurimit dhe udhëzimet shoqëruese, ka rezultuar me kontrata potencialisht të parregullta dhe me mundësinë e humbjeve financiare për komunën. Ekziston rreziku i mëtejme se është arritur vlerë e dobët për paranë e shpenzuar në këtë kontratë.

**Rekomandimi 11** Kryetarja e Komunës duhet të siguroj se në të gjitha rastet e prokurimit, vlerësimi i ofertave nga ana e komisioneve bëhet në mënyrë objektive dhe në mënyrë strikte respektohen të gjitha kriteret e vendosura në dosjen e tenderit.

## **Çështja 12 - Mungesa e evidencave tek shpenzimet e servisimit dhe derivateve për automjetet - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Në drejtoratin e administratës së përgjithshme nuk ka zyrtarë përgjegjës (logjistikë) që merret me mbajtjen e evidencave për shpenzimet e derivateve dhe servisimet për automjetet e komunës. Ne nuk na është ofruar në mënyrë analitike vlera e shpenzuar për servisim dhe vlera e shpenzuar e derivate për secilin automjet. Sipas drejtorisë së financave dhe raportit të freebalancit, shpenzimet për servisime dhe mirëmbajtje për vitin 2013 ishin 31,333€ dhe për derivate 158,117€. Komuna, gjithashtu, nuk mban evidenca lidhur me fletudhëtimet mbi kilometrat e kaluara, me çka do të konfirmohej norma e shpenzimeve të derivateve dhe nëse automjetet janë përdorë për qëllime zyrtare.

Praktika të njëjta ishin edhe në Qendra Kryesore për Mjekësi Familjare (QKMF). Ekziston një kontratë për "Riparimin dhe mirëmbajtjen e veturave zyrtare" por që nuk dihet se cilët ishin artikujt e servisimit dhe për cilat automjete. Po ashtu, rast i ngjashëm ishte edhe me furnizimin me goma të automjeteve në QKMF. Sipas deklaratës së zyrtarit përgjegjës për menaxhim me vetura në QKMF gjatë vitit 2012 dhe 2013 ishin furnizuar me 36 goma të përdorura, ndërkaq pagesa ishte bërë për goma të reja. Sipas pohimeve të zyrtarit për menaxhimin e autoparkut në QKMF, kjo kishte ndodhur me urdhërin e Drejtorit të shëndetësisë. Veprimi si i tillë ngrit dyshime për pagesa të parregullta si dhe përmban elemente të mashtrimit.

**Rreziku** Mungesa e evidencave për automjetet zyrtare për shpenzimet e servisimeve dhe derivateve nga drejtoratet përkatëse dhe furnizimi me goma të përdorura, rritë rrezikun se mund të ndodhin shpenzime të pa arsyeshme me efekte direkte në dëmtimin e buxhetit të komunës.

**Rekomandimi 12** Kryetarja e Komunës duhet që të siguroj se kontrole të duhura janë rivendos në mbajtjen e saktë të evidencave për shpenzimet e derivateve dhe servisimeve për secilin automjet zyrtarë veçmas. Më tej, Kryetarja e Komunës duhet të sigurojë që rasti i furnizimeve dhe pagesave për goma të hetohet plotësisht dhe të ndërmerren masat adekuate për këtë rast.



### **Çështja 13 - Mos nënshkrimi i deklaratës mbi disponueshmërinë e mjeteve, siguria e ekzekutimit në kundërshtim me dosjen e tenderit - Prioritet i lart**

**E gjetura** Tek të gjitha kontratat e rishikuara tek projektet kapitale në kemi vërejtur se deklarata mbi disponueshmërinë e mjeteve nuk është nënshkruar nga ZKF, siç kërkohet me LPP.

Tek kontratat Ndërtimi i AMF-së në Fshatin Novosellë e Ulët me vlerë prej 38,607€, dhe Ndërtimi i AMF-së në Ramoc me vlerë 40,026€, kemi vërejtur që zotimi i mjeteve për këto kontrata për vitin 2013 është bërë nga 5,000€ për secilën kontratë. Po ashtu, te këto kontrata, sigurimi i ekzekutimit në dosjen e tenderit ishte kërkuar të jetë 10% e vlerës së kontratës, ndërsa operatori ekonomik kishte dorëzuar sigurimin e ekzekutimit në vlerë prej 500€. Raste të njëjta ishin edhe te kontratat "Ndërtimi i rrugës në fshatin Damjan" në vlerë 470,102€, "Ndërtimi me asfalt i rrugës në fshatin Gërqin" me vlerë 338,433€, "Ndërtimi i parkut memorial në fshatin Meje" me vlerë prej 1,060,774€, "Ndërtimi me asfalt i rrugës Rogove-Ujz" me vlerë prej 234,763€.

**Rreziku** Mos nënshkrimi i deklaratës mbi disponueshmërinë dhe zotimi i pamjaftueshëm i fondeve nga zyrtarët përgjegjës për projektet e caktuara rritë rrezikun që obligimet kontraktuese të mos paguhen. Po ashtu, mungesa e sigurimit të ekzekutimit rrit rrezikun që kontratat të mos implementohen.

**Rekomandimi 13** Kryetarja e Komunës duhet të sigurojë se do të bëhet një rishikim i të gjeturave të auditimit në të cilat proceset nuk janë aplikuar në mënyrë efektive, si dhe të përcaktojë se pse kanë ndodhur dështimet në to. Veprimet/proceset e duhura duhet të implementohen për të siguruar se dështimet e tilla nuk do të ndodhin në të ardhmen.

#### Çështja 14 - Furnizimi me tonerë - Prioritet i lart

**E gjetura** Komuna kishte lidhur kontratë për furnizim me material zyrtarë në vitin 2012 me "SN Computer". Në specifikacionin teknik të përgatitur nga ana e njësisë kërkuese ishin përfshirë 35 lloje të tonerëve. Operatori ekonomik fitues për 30 nga 35 lloje të tonerëve të kërkuar, kishte ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta prej 1.15€ për copë, dhe në pesë lloje kishte ofruar çmime prej 25€ deri 50€ për copë. Ne kemi testuar katër pagesa në vlerë 6,788€ dhe kemi vërejtur se komuna është furnizuar vetëm me pesë llojet e tonerëve me çmimet prej 25€ deri 50€, ndërsa me 30 llojet e tonerëve tjerë me çmime prej 1.15€ për copë nuk ishte bërë asnjë furnizim.

Ne kemi ekzaminuar edhe gjendjen në depo ku kemi konstatuar se depoisti nuk mbanë evidenca vjetore për hyrjet dhe daljet e materialeve të pranuar..

**Rreziku** Përfshirja në specifikacionin teknik të llojeve të tonerëve me të cilat autoriteti kontraktues asnjëherë nuk është furnizuar, ngrit dyshimet për përshtatjen e këtij tenderi. Po ashtu, mungesa e evidencave mbi hyrjet dhe daljet e depos rrit rrezikun që tonerët të keqpërdoren.

**Rekomandimi 14** Kryetarja e Komunës duhet të siguroj se njësitë kërkuese furnizohen me artikuj që janë të domosdoshëm për veprimtarinë e rregullt. Të gjitha hyrje-daljet e depos duhet të jenë të evidentuara qartë, sidomos për artikujt në vlera të larta.

### 4.5.2 Kompensimet ( pagat dhe mëditjet)

#### Përshkrimi

Buxheti i planifikuar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 10,206,650€, ndërsa shpenzimet për këtë kategori ishin 10,149,794€ apo rreth 99%.

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me a) kontrollin i pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listën e pagave b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Për këtë kategori testuam 66 mostra ku rishikuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e payrollit në MAP. Po ashtu kemi shikuar nëse pozitat e zyrtarëve dhe koeficientet janë në pajtueshmëri me formën e sistemit të payrollit dhe listës së pagave. Testet tona në këtë fushë kanë identifikuar çështjet në vijim:

**Çështja 15 - Mos respektimi i procedurave të rekrutimit dhe kritereve në konkurs-  
Prioritet i lartë**

**E gjetura** Me datë 04.11.2013 Drejtoresha e QKMF-së ka nënshkruar kontratë pune me një të punësuar në pozitën Asistente e stomatologjisë. Për këtë pozitë nuk janë aplikuar procedurat e hapura të rekrutimit, siç kërkohet me nenin 8 pika 1 të Ligjit të Punës. Rast i njëjtë është edhe nënshkrimi i kontratës me një të punësuar si Infermiere në QKMF.

Me datë 12.04.2013 Ushtruesi i detyrës së drejtorit të QKMF-së ka shpallur konkurs të brendshëm për pozitën Kryeshf i Mjekësisë Familjare dhe me të janë përcaktuar kushtet që duhet plotësojnë kandidatët për atë vend pune. Nga dokumentacioni i analizuar lidhur me këtë proces, vërehet se është përzgjedhur kandidati i cili nuk e plotëson kushtin themelor të kërkuar në konkurs “Të jetë specialist - Drejtimi Mjekësi Familjare” pasi që personi i përzgjedhur ishte specialist i pediatriisë.

**Rreziku** Emërimi i zyrtarëve duke anashkaluar procedurat e hapura të konkursit dhe duke i anashkaluar kriteret të parapara me konkurs, mund të ndikoj në dëmtimin e konkurrencës dhe të përzgjidhen kandidatët të cilët nuk i kanë plotësuar kriteret adekuate.

**Rekomandimi 15** Kryetarja e Komunës duhet të sigurojë se janë respektuar të gjitha procedurat e rekrutimit dhe emërimit në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

#### **Çështja 16 - Ushtrimi i dy pozitave brenda orarit të njëjtë të punës- Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Në një rast ne kemi vërejtur që një e punësuar ishte paguar për dy vende pune brenda orarit të njëjtë; njëriën si udhëheqëse e sektorit të shëndetit primar në drejtorinë e shëndetësisë me orar të plotë dhe tjetrën si mësimdhënëse e stomatologjisë për 6 orë në javë në gjysmën vjetorin e dytë 2012/13 dhe 9 orë në javë në gjysmën vjetorin e parë 2013/14 . Një gjë e tillë është në kundërshtim me nenin 36 të Ligjit mbi Shërbyesit Civil dhe me rregulloren nr. 05/2010 për orarin e punës.

**Rreziku** Ushtrimi i dy pozitave të punës brenda orarit të njëjtë nga i njëjti person, është një konflikt interesi dhe ka ndikim në kryerjen efektive të funksionit primar.

**Rekomandimi 16** Kryetarja e Komunës duhet të ndërmerr veprimet e duhura për ndërprerjen e praktikave të tilla, si dhe të analizoj nëse ky është vetëm një rast i izoluar apo kjo është një dukuri sistematike.

### **4.5.3 Subvencionet dhe Transferet**

#### **Përshkrimi**

Shpenzimet e planifikuara për subvencione dhe transfere gjatë vitit 2013 kanë qenë 602,300€ ndërsa të realizuara 457,649€. Ne kemi ekzaminuar gjithsej 26 mostra në vlerë prej 244,320€, dhe kemi vërejtur si më poshtë:

Komuna ka nxjerrë rregulloren për subvencione që ka qenë rekomandim i vitit të kaluar nga AP, po ashtu komuna e ka fuqi edhe një udhëzues intern që rregullon mënyrën e shpenzimeve dhe procedurat që duhet të ndiqen me rastin e shpenzimeve në nivel të komunës. Në këtë udhëzues intern ceket se komuna me rastin e subvencionimit duhet të lidhë një marrëveshje mirëkuptimi me përfituesit.

## **Çështja 17 - Subvencionet janë shpenzuar për kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Komuna kishte paguar 25,800€ për “Procesin e stolisjes së rrugëve dhe shesheve të komunës për festat e fund vitit” nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, pa përfillur asnjë procedurë të prokurimit lidhur me përzgjedhjen e ofruesit të shërbimeve. Pagesa ishte bërë vetëm me faturën e dërguar nga OE.

Me datë 28.02.2013 Kryetari i Komunës kishte aprovuar kërkesën nga Zyra për barazi gjinore për realizimin e vizitës dy ditore në Republikën e Shqipërisë me rastin e Festës së 8 Marsit të grupit të 120 grave të punësuar në komunë. Shpenzimet për këtë ishin në vlerë prej 3,500€. Me këtë rast nuk është zhvilluar asnjë procedurë lidhur me përzgjedhjen e ofruesit të shërbimeve. Përveç faturës nuk ka ndonjë dëshmi përcjellëse (lista e pjesëmarrësve, fatura nga hoteli etj.). Këto mjete të ndara nga buxheti i komunës për punëtorët e komunës nuk kanë një përfitim publik dhe janë të dyshimta.

Me datën 11.03.2013 komuna kishte vendosur për të vazhduar bashkëpunimin me mediumin TV SYRI për ofrimin e shërbimeve profesionale të përcjelljes së aktiviteteve të Komunës. Shpenzimet janë përlllogaritur në vlerë prej 1,500€ në muaj, përkatësisht 18,000€ në vit. Pagesat ishin bërë nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, e jo nga kategoria mallrat dhe shërbimet. Gjithashtu me datë 12.09.2013 është aprovuar kërkesa e këtij mediumi për subvencionim në vlerë 5,000€ për mbulimin e aktiviteteve për zgjedhjet lokale 2013.

Në një rast komuna me vendim të kryetarit të datës 31.12.2013 nga kategoria e subvencioneve kishte bërë pagesën në vlerë prej 54,300€ për Ngrohtoren e Qytetit për mbulimin e borxheve të komunës të krijuara gjatë periudhës 2011- 2013 për shërbimet e ngrohjes.

**Rreziku** Pagesat nga kategoria e subvencioneve dhe Transfere për mallra dhe shërbime ndikon në mbivlerësim të subvencioneve dhe nënvlerësim të mallrave dhe shërbimeve.

**Rekomandimi 17** Kryetarja e Komunës duhet të siguroj se janë zbatuar të gjitha procedurat dhe kriteret për dhënien e subvencioneve, para se të bëhet ndarja e tyre. Mjetet e planifikuara për subvencione dhe transfere duhet të shpenzohen në bazë një rregullore të brendshme ku specifikohen qartë veprimtaritë të cilat mund të subvencionohen

## **Çështja 18 - Mungesë raportesh nga përfituesit për shpenzimet e dedikuara - Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Në një rast komuna ka subvencionuar një organizatë jo qeveritare (OJQ) "KDC" për organizimin e Darkës së Lamës me vendim të kryetarit të datës 12.12.2012 në vlerë 9,850€. Komuna nuk ka bërë një marrëveshje mirëkuptimi (MIM) për mënyrën e shpenzimit dhe të raportimit nga përfituesi. Në planin e shpenzimeve të ofruar nga "KDC" është paraparë që të shpenzohen diku rreth 900€ për shtypje të mirënjohjeve dhe fletëpalosjeve, ndërsa sipas dëshmive të ofruara për këtë aktivitet janë shpenzuar 4,932 € tek EURO Print dhe 513€ tek Brovina Graf që është në kundërshtim me planin e aprovuar.

Me datë 11.10.2012 Kryetari i Komunës kishte aprovuar kërkesën e Grupit Muzikor Qumilat për dhënie të subvencioneve në vlerë prej 2,500€ për organizimin e koncertit të tyre jubilar. Kjo ndërlidhet edhe me manifestimin kushtuar 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. Përgesha është bërë me datë 19.03.2013. Komuna nuk ka lidhur një marrëveshje siç kërkohet me udhëzuesin intern të komunës lidhur me mënyrën raportimit dhe nuk kishte pranuar dëshmi relevante lidhur me shpenzimin e këtyre mjeteve. Rast i njëjtë është edhe aprovimi i kërkesës së OJQ Prosperiteti për dhënie të subvencioneve në vlerë prej 1,000€ për realizimin e programit të radios kushtuar komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

**Rreziku** Dhënia e subvencioneve pa bërë MIM siç kërkohet me udhëzimin intern të komunës me përfituesit që do tregonte mënyrën e shpenzimit dhe të raportimit të mjeteve të dhëna rritë rrezikun se fondet e dhëna nuk do ta arrijnë qëllimin për të cilin janë marrë.

**Rekomandimi 18** Kryetarja e Komunës duhet të sigurojë që të behën MIM me përfituesit duke i obliguar ata të raportojnë në mënyrë që të sigurohet që subvencionet kanë arritur objektivat për të cilat janë dhënë.

## Çështja 19 - Dhënia e bursave jo sipas kriterëve –Prioriteti i mesëm

**E gjetura** Komuna ka shpallur konkurs me vendim të Kryetarit për shpërndarjen e 50 bursave nga 600€ në vit. Gjithsej fondi i ndarë për bursa ishte në vlerë 30,000€. Gjatë testimit të 35 dosjeve ne kemi konstatuar se ishin shkelur disa nga kriteret e përcaktuara si:

- Shpërblimi i dy studentëve me notë 6.5 dhe 6.56 përderisa kriter ishte nota mesatare mbi 7.0; dhe
- Dy studentë tjerë me notë mesatare mbi 9 nuk ishin shpërblyer me bursë komunale.

**Rreziku** Komisioni i caktuar për vlerësimin e kandidatëve kishte shkelur kriteret e përcaktuara në konkursin për bursa dhe rregulloren e brendshme për subvencione.

**Rekomandimi 19** Kryetarja e Komunës duhet të rivendos kontrollin shtesë me rastin e dhënies së bursave, në mënyrë që komisioni për vlerësimin e aplikuesve të jetë i paanshëm, i drejtë dhe transparent në përzgjedhjen e përfituesve.

## 4.6 Pasuritë dhe detyrimet

### 4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

#### Përshkrim

Komuna ka vazhduar me procesin e regjistrimit të pasurive në vitin 2013. Në vitin 2012 pasuritë jo-financiare mbi 1,000€ ishin regjistruar në shumë prej 34,896,000€, ndërsa deri në fund të vitit 2013 vlera e pasurive të regjistruara ishte 38,469,845€. Megjithëse procesi i kompletimit të regjistrimit të pasurive shoqërohet me një sërë sfidash, ne inkurajojmë menaxhmentin e komunës të vazhdoj me procesin deri në regjistrimin final.

## **Çështja 20 - Mungesa e regjistrimit të plotë të pasurive dhe mos pajtueshmëri me rregulloren për pasuri - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Ne kemi vërejtur që komuna mban regjistra të pasurive kapitale dhe jo kapitale. Mirëpo, këto evidenca nuk ishin plotësuar me pasuritë të cilat janë identifikuar si pronë e komunës. Komisioni i formuar në vitin 2010 kishte identifikuar 215 banesa, 9 shtëpi dhe 8 lokale që janë në pronësi të komunës, por këto patundshmëri ende nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël të pasurive.

Në regjistrin e pasurisë jo financiare të komunës me vlerë nën 1,000€, kemi vërejtur se në këtë regjistër nuk janë të përfshira pasuritë që janë në përdorim nga Drejtoria e arsimit dhe Drejtoria e shëndetësisë. Sipas regjistrit të pasurisë jokapitale të dërguar nga drejtoria e arsimit vlera e pajisjeve nën 1,000€ është 2,543,580€ dhe për këto pajisje nuk ishte aplikuar zhvlerësimi i tyre siç parashihet me rregullën nr. 02/2013 neni 22 pika 3. Drejtoria e shëndetësisë kishte bërë vetëm evidentimin fizik të pasurisë jo kapitale pa ndonjë vlerë të caktuar financiare.

Gjatë vitit 2013 komuna kishte formuar komisione në kuadër të drejtorive për vlerësimin e pasurisë nën 1,000€. Sipas procesverbaleve të këtyre komisioneve disa pajisje në vlerë prej 3,970€ duhej të largoheshin nga përdorimi, por kjo nuk ishte bërë.

**Rreziku** Mos regjistrimi i plotë i të gjitha pronave përkatësisht objekteve afariste, ka rezultuar me shfrytëzimin e tyre nga individë të ndryshëm për aktivitete biznesi, duke mos i paguar komunës kurrfarë taksash. Mungesa e regjistrave të plotë të pasurive vështirëson identifikimin e pasurive për të konfirmuar ekzistencën e tyre, si dhe rrit rrezikun që ato të keqpërdoren, madje edhe të humben dhe tjetërsohen.

**Rekomandimi 20** Kryetarja e Komunës duhet të siguroj që sa më parë të formoj një komision kompetent i cili do të bënte vlerësimin dhe inventarizimin e drejtë dhe të plotë të të gjithë pasurive jofinanciare që janë në pronësi të komunës. Gjithashtu, menaxhmenti duhet të monitoroj edhe rezultatet e vlerësimit.



## 4.6.2 Trajtimi i borxheve

### Përshkrim

Pasqyra e obligimeve të pa paguara në fund të vitit 2013 është 5,581,962. Prej tyre sipas faturave ishin 2,358,000€, ndërsa sipas situacioneve të punëve të kryera ishin 3,223,962€.

---

### Çështja 21 - Hyrje në obligime përtej buxhetit të aprovuar - Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna kishte hyrë në obligime më shumë se ndarjet buxhetore. Fondi i ndarë për kategorinë e mallrave dhe shërbime për vitin 2013 ishte 1,639,652€, ndërsa ishin shpenzuar 1,522,468€ apo 93%, ndërsa obligimet e pa paguara për këtë kategori në fund të vitit 2013 ishin 401,000€. Hyrja në obligime për këtë kategori përtej buxhetit ishte 283,816€.

Buxheti i ndarë për kategorinë e investimeve kapitale ishte 6,792,657€, ndërsa ishin shpenzuar 6,003,327€. Obligimet e mbetura në fund të vitit 2013 për kapitale ishin 5,063,962€. Prej tyre sipas faturave ishin 1,840,000€, dhe sipas situacioneve mbi punët e kryera ishin 3,223,962€. Obligimet e krijuara përtej buxhetit të lejuar ishin rreth 74.5%. Nga kjo mund të konkludojmë se komuna nuk i kishte menaxhuar drejt obligimet e papaguara dhe kjo ka shkaktuar që të rriten obligimet në fund.

**Rreziku** Krijimi i obligimeve të shumta që duhen paguar në vitin 2014, rritë rrezikun që planet e ardhshme të shpenzimeve të mos arrihen për shkak të nevojës për të paguar obligimet e viteve paraprake. Hyrja në obligime përtej ndarjeve buxhetore mund ta sjellë komunën në vështirësi financiare dhe me mundësinë potenciale për hapjen e kontesteve gjyqësore. Kjo sjellë në pikëpyetje serioze edhe realizimin e projekteve të parapara.

**Rekomandimi 21** Kryetarja e Komunës duhet të siguroj se me rishikim buxheti të kërkoj fonde shtesë për mbulimin e këtyre detyrimeve. Problemi si i tillë duhet të diskutohet me MF dhe Qeverinë. Gjithashtu, një monitorim i buxhetit duhet të bëhet në baza të rregullta për të siguruar se problemet e identifikuar në programin e PIP-it të prezantuar në kapitullin 4.4.1 të këtij raporti do të menaxhohen në pajtim me kërkesat ligjore.

## 4.7 Sistemi i auditimit të brendshëm

### Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit.

NJAB-i për vitin 2013 kishte planifikuar pesë auditime sipas planit dhe kishte arritur që ta realizoj planin në tërësi. Auditimet kishin mbuluar aktivitetet që kanë qenë në proces edhe për vitin aktual.

Ne kemi rishikuar një dosje të auditimit të brendshëm dhe kemi konstatuar se ekziston programi i auditimit dhe gjetjet e auditimit janë dokumentuar me dëshmitë mbështetëse. Adresimi i duhur i rekomandimeve të NJAB do të ndihmoj në përmirësimin e kontrolleve të brendshme të organizatës.

Po ashtu, NJAB-i kishte përgatitë raporte tremujore të cilat i kishte dërguar edhe në njësinë qendrore Harmonizuese në MF.

Komuna nuk kishte themeluar Komitetin e Auditimit.

**Çështja 22 - Adresimi i rekomandimeve nga NJAB dhe themelimi i Komitetit të Auditimit  
- Prioritet i lartë**

**E gjetura** Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur se menaxhmenti nuk kishte trajtuar me kujdesin e duhur rekomandimet e dhëna nga NJAB. Komuna akoma nuk ka të themeluar komitetin e auditimit.

Njab ka një auditor, i cili njëkohësisht është edhe drejtor njësie. Ai kishte përgatitë planin vjetor të auditimit, i cili është aprovuar nga menaxhmenti i Komunës për vitin 2013. Duke u bazuar në udhëzimin administrativ nr. 23/2009, dhe duke pasur parasysh buxhetin dhe madhësinë e organizatë, komuna e Gjakovës duhej t'i kishte deri në 3 auditorë.

**Rreziku** Mungesa e gatishmërisë së menaxhmentit për adresimin e rekomandimeve të dala nga NJAB, rrit rrezikun që këto rekomandime të mos adresohen. Po ashtu, mos plotësimi i njësisë me stafin e duhur rritë rrezikun se nuk do mund të mbulohen fushat me rrezik të lartë, dhe gabimet dhe pa rregullsitë të përsëriten.

**Rekomandimi 22** Kryetarja e Komunës duhet të sigurojë se do të bëjë një plan veprimi se si mendon që gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm të adresohen nga të gjitha nivelet e menaxhimit. Po ashtu, duhet të rishikoj mundësinë që NJAB do të plotësohet me stafin shtesë sipas kërkesave të udhëzimit administrativ nr. 23/2009. Kryetarja e Komunës duhet po ashtu të sigurojë themelimin e Komitetit të Auditimit brenda afateve optimale.

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar nëse** arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornizë për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk përhapen në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë materiale por nuk përhapen.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe përhapen në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë edhe materiale edhe të përhapen. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705<sup>19</sup> jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
2.1 Prezantimi i Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të siguroj se plani sistematik i përpilimit të pasqyrave financiare inkorporon kërkesën për të përfshirë tërë vlerën e pasurive që e posedon komuna.			JO
3.Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të siguroj që do të hartohet plani i veprimit ku në mënyrë të qartë do të përcaktoj afate kohore për adresimin e rekomandimeve me anëtarët e stafit llogaridhënës.			JO
4.4 Te hyrat- mangësitë e softuerit	Kryetari duhet të sigurojë se një sistem i duhur i regjistrimit është vënë në funksion për të mbështetur inkasimin dhe regjistrimin e të hyrave. Nëse instalimi i një programi të veçanta nuk është i mundur, sistemi manual (Excel) duhet të përmirësohet.		Pjesërisht është adresuar	
4.4.1 Të hyrat-qiramarrësit e lokaleve	Kryetari duhet të zbatoj një proces regjistrimi të të gjitha pronave dhe ngarkesave shoqëruese, dhe të përcjellë në baza mujore arkëtimin e qirave.			JO

4.4.2 Të hyrat-Lejet e ndërtimit	Kryetari duhet të rishikojë sistemet ekzistuese për të kontrolluar projektet e ndërtimit, të vlerësojë efektivitetin e tyre përfshirë edhe mbështetjen e dhënë ligjore dhe zbatimin e përmirësimeve të kërkuara. Inspektorati i ndërtimit duhet të aplikojë të gjitha kontrollet e duhura.		Pjesërisht është adresuar	
4.4.3 Inkasimi i dobët për taksën e veprimtarisë	Kryetari duhet të siguroj se Departamenti i të hyrave posedon një përditësim të vazhdueshëm të bazës së të dhënave të bizneseve aktive për të mbledhur borxhet e mbetura.			JO
4.4.4 Borxhet e painkasuara	Kryetari duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative (nëse ka nevojë).			JO
4.5 Shpenzimet-Mungesa e zotimit të fondeve	Kryetari i duhet të diskutoj me zyrtarët e prokurimit për dëmet që sjellë anashkalimi i procedurave të duhura të prokurimit, si dhe të marr masat që procedurat e prokurimit kryhen në përputhje të plotë me Ligjin. Fondet për financimin e projekteve duhet siguruar para se procedurat e prokurimit të kenë filluar.			JO
4.5.1 Sigurimi i ekzekutimit jo sipas rregullave	Kryetari duhet të siguroj se menaxheri i prokurimit zhvillon procedurat e prokurimit që ndërlidhen me kërkesat e specifikuara të dosjes së tenderit, me synimin që të ngritët siguria e ekzekutimit të punimeve.			JO



4.5.2 Çertifikim i pagesave pa dokumentacion të justifikueshëm	Kryetari duhet të siguroj se çertifikimi i çdo pagese do të bëhet në bazë të dëshmive të cilat e vërtetojnë se shpenzimi vërtetë ka ndodhur.		Pjesërisht është adresuar	
4.5.3 Thesari ekzekuton pagesat pa raport të pranimit	MF - Thesari duhet të marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuese dhe të zbatoj LMFPF plotësisht, duke mos ekzekutuar pagesa pa pasur raportin e komisionit për vlerësim dhe pranim të projektit, si dhe përmbushjen e kushteve tjera për pagesë.	PO		
4.5.4 Subvencionet-Furnizim pa procedura të prokurimit	Kryetari duhet të siguroj kritere të qarta se cilat do të jenë fushat që mund të subvencionohen, cilat shuma mund t'i aprovoj Kryetari e cilat Asambleja komunale, dhe aspektet tjera procedurale (raportimi, mbikëqyrja, etj.). Dukuria e furnizimeve në këtë mënyrë duhet të ndërpritet.			JO
4.5.5 Transferimi i mjeteve pa projekt	Kryetari duhet të siguroj se pagesa për subvencione dhe transfere bëhet vetëm në bazë të dëshmive duke marrë parasysh kërkesën dhe projektin detal me qëllim që të zvogëlohet mundësia për manipulim të mundshëm me paranë publike.			JO
4.5.6 Mungojnë listat me nënshkrime të përfituesve	Kryetari duhet të siguroj se rregullorja do të aprovohet së shpejti në Kuvendin Komunal dhe ajo do të jetë aplikative me rastin e shpenzimeve nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve.	PO		

4.6.1 Pasuritë	<p>Kryetari duhet të siguroj që në një kohë sa më të shkurtër të riaktivizoj komisionin dhe të vazhdoj me procesin e mbetur të regjistrimit.</p> <p>Gjithashtu, një komision inventarizimi duhet të themelohet çdo vit për të bërë barazimet e gjendjes kontabël me gjendjen faktike të pasurive.</p>			JO
4.6.2 Trajtimi i arkëtueshmeve	<p>Kryetari duhet të përgatis një Plan veprimi ku do të propozohen udhëzime të qarta për të gjithë sektorët relevant të komunës për ngritjen e inkasimeve të të gjitha borxheve. Plani duhet të përmbaj prioritete, ndarjen e borxheve sipas vjetërsisë, afatet kohore për veprimet që duhet të merren, arsyet e mos pagesës, mekanizmat e duhur dhe diskutimin e arritjeve, së paku dy herë në vit.</p>			JO
4.7 Trajtimi i borxheve	<p>Kryetari duhet të siguroj hartimin e një buxheti real dhe të qëndrueshëm. Kontrollat buxhetore duhet të forcohen nga mbajtësit e buxheteve, për të siguruar balancin midis obligimeve dhe fondeve në dispozicion.</p>			JO
5 Auditimi i brendshëm	<p>Kryetari duhet të siguroj se në planin vjetor të NJAB përfshihet auditimi i fushave me rrezik të lartë, si: auditimi i të hyrave, shpenzimeve, subvencioneve dhe transfereve dhe pasurisë, duke patur si fushëveprim parësor aktivitetet e vitit aktual. Gjithashtu, duhet të hartohet një Plan veprimi për adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të NJAB.</p>		Pjesërisht është adresuar	